- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

b. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit që prokurohet, e konfirmuar në menyrë elektronike për secilin prej Loteve për të cilat ofertuesi konkuron.

2. Operatori ekonomik të ketë të punësuar minimumi 2 (dy) punonjës të siguruar vërtetuar kjo me vërtetim Formulari E-SIG 02/a nga sigurimet shoqërore për periudhën tetor, nëntor, dhjetor 2018, e konfirmuar në menyrë elektronike.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Furnizime të së njëjtës natyrë (furnizim me artikuj ushqimorë – sipas lotit) me vlerë e cila nuk duhet të jete me e vogël se 40 % e fondit limit të lotit të ushqimeve/Loteve për të cilat ofertuesi konkuron.

- Kerkohen të paraqiten kontrata të ngjashme, të realizuara në 3 vitet e fundit dhe vërtetim për realizimin me sukses të tyre.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

2.3.1 Liçensa profesionale lidhur me mallrat objekt i kontratës që prokurohet , Licence e leshuar nga Organet tatimore për tregëti me shumicë ose me pakicë të artikujve ushqimorë.

2.3.2 Operoretorët ekonomike duhet të këtë Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për objektin e prokurimit të lotit që konkuron.

2.4 Kriteret të vecanta për kualifikim sipas Rekomandimit të APP-se nr 10181 prot date 19.11.2018

a. Në objektet e prokurimit për prodhim/perpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njërez, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Licence, kategoria II. I .A.I - "Prodhim, perpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njërez", të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

a.1 . Për të plotësuar këto kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II. I .A. I - "Prodhim, perpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njërez" në emër të tij, pasi licenca duhet të i perkase operatorit ekonomik të interesuar të ofertoje për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor.

a.2. nuk lejohet përdorimi i licences të një operatori tjetër ekonomik.

a. 3. Për këtë lloj procedurë të prokurimit, personeli që do të realizojë procesin e prodhimit të ushqimit, të kësaj kualifikimi dhe nevojshëm profesional, të vërtetuar me dokumentacion përkatës.

b. Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga QKB duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurrohet.

c. Operatori ekonomik të jetë i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018 (loti 1), ose ekuivalente me to.

cl. Operatori Ekonomik të ketë në pronësi ose në përdorim ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara për të gjithë periudhën e zbatimit të Kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike.

e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim, automjet të përshtatshëm ATV (frigorigjer) për transportimin e mallrave (loti 1 dhe 2), automjet të përshtatshëm për transportimin e mallrave (loti 3), në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, dhe që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare.

➤ Për automjetin në pronësi: akt pronësie (kontrata/fatura shitblerje ose kontrata dhurimi), leje qarkullimi, akt kollauidimi dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.

➤ Për automjetet që nuk janë në pronësi: kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht 12 muaj, leje qarkullimi, akt kollauidim dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.

f. Për lotin e 2 kërkohej që subjekti të ketë kontratë me fermerë, operatori ekonomik ofertues duhet të sigurojë dhe të dokumentojë furnizimin në vijimësi e të vazhdueshëm për periudhën e kërkuar nga ferma vendase, ose nga importi, me dokumentacion të rregullt.

g. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Produktet ushqimore, objekt i Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 1344, datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore", neni 4 dhe 13, të jenë të pajisura me etiketat respektive.

Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike të produktit të ofertuar/mostres që përfaqesojnë artikullin duhet të perputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe të Standardit Shtetëror përkatës. Standardet shtetërore për karakteristikat e produkteve ushqimore janë të disponueshme dhe janë të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit (DPS) në faqen e internetit www.dps.gov.al.

Frigoriferet e instaluar në ambientet e operatorit ekonomik të këne rregjistrat përkatës për monitorimin e temperaturës, sipas Udhezimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22 datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjenes për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor".

SHEQERI – duhet të jetë me treguesit fiziko-kimike: Sheqer i pastër 99.6%, hiri deri 0.07%, lageshtira deri në 0.16%, Pamja: pluhur i perbere nga kristale të imeta e të njolleta. Ngjyra: I bardhë në shkelqim, treguesit shqisore: I derdhur I thatë, me shije të embel pa erë të huaj, përdorim të njëtrajtshëm, të tretet plotësisht. Amballazhimi në pako letre 1 kg ose thase lini ose

plastmasi 50 kg dhe etiketuar sipas standartit ne fuqi.

VAJ USHQIMORE – te jete sipas standartit shteterore 203: 2003. Treguesit fiziko-kimike: Dendesia relative ne 20 grade celcius/uje ne 20 grade C 0.918-0.923. Numri I refraksionit 1.461-1.468. Numri I sapunifikimit 188-194. Treguesi I jodit 118-141. Treguesit e cilesise: ngjyre e verdhe ne te lehte. Era dhe shija karakteristike e vajit te lulediellit, pa ere e shije te huaj. Numri I peroksive: jo me shume se 10 mek O₂ aktive /kg vaj. Numri I aciditetit: jo me shume se 0.4 mg KOH gr vaj. Shmangia ne vellim deri ne 1 %. Kontaminuesit jo me shume se: lende te patretshme 0.05%. Permbajtja e sapuneve 0.005%. Lende fluturuese, ne 105 grade C 0.2. Amballazhimi dhe etiketimi: Amballazhimi behet ne shishe plastike dhe kapacitet 1 liter. Mbi cdo amballazh vendoset etika per daten e prodhimit, llojin e vajit, masa ne litra, etj. Etiketimi behet sipas legjislacionit ne fuqi.

MAKARONAT – Te jene me treguesit shqisore: ngjyra e bardhe ne te verdhe, pa shije te hidhur e te tharte, pa ere te huaj. Treguesit fiziko-kimike: lageshtira deri ne 13%, aciditeti jo me shume se 0.16%, rritja e volumit jo me pak se dy here. Nuk lejohen demtues. Mielli I stazhionuar jo me pak se 15 dite, I sigur 100%, nuk lejohen demtues. Amballazhimi: ne pako 0.5 ose 1 kg, I etiketuar sipas standartit dhe te futura ne kuti kartoni.

ORIZ – Te jete me treguesit shqisore: Pamja kokrra te shendosha, te plota, te pastra e pa myk. Ngjyra e bardhe. Era pa shije te tharte e pa ere myku. Treguesit fiziko kimike: lageshtire deri ne 15%, kokrra te thyera deri ne 12%, lende te huaja deri ne 0.4 %, kokrra te verdha deri ne 4%. Nuk lejohen demtues. Amballazhi ne pako 1 kg, letre ose plastmasi ose ne thase lini ose plastmasi 50 kg.

RECEL FRUTASH – Kokerr, I amballazhuar me ene hermetike dhe pa papasterti, duhet te jene sipas standartit shteterore te amballazhuar ne vazo 450 gr, me etiketim te rregullt ku te lexohet qarte prodhuesi , data e prodhimit, data e skadences e cila duhet te jete mbi 9 muaj nga data e furnizimit, si dhe permbajtja e tyre.

SALCE – Duhet te jete e perpunuar me baze vetem domate, prodhim vendi ose I huaj. Malli te jete I amballazhuar ne kuti llamarine 400 gr ose 500 gr. Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen Shqipe kur malli eshte I huja. Permbajtja te jete salce dhe kripe. Perberia e mases te jete homogjene dhe me 18-20% lende e thate. Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja. Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle. Shija te jete e embel pa aciditet. Aroma te jete e kendsheme ne perputhje me aromen e domates se fresket karakteristike e llojit. Ne etikete te jete e shenuar qarte firma prodhuese dhe ajo tregtuese. Kapaku te jete I mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadences, nuk lejohet me afat perdorimi me shum se nje vit.

BUKE GRURI – do te prodhohet me miell rrezje 70% ,I stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete I fresket, me ngjyre, ere, shije dhe lageshtire konform standarteve perkatese te miellit me rreze 70%. Mielli nuk duhet te kete asnjelloj lende te huaj. Buka duhet te kete form te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi I bukes duhet te jete I maftueshem.Shije,era,lageshtira dhe aciditeti I bukes duhet te jet konform standartit teknik te prodhimit te saj. Korja e bukes-duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa shkeputjet e saj nga tuli, ngjyra e njellojt mjalti ne te kuqerremt ne te gjithe siperfaqen. Tuli duhet te jete 9I pjekur mire me porozitet te imet ne te gjithe vellimin e tij

dhe nuk duhet të ket gjurme mielli të pa brumosura nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere të huaj, me shije të hidhur e të thart, me lende të huaja, me lageshtirë jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko-kimik : Buka perferohet në formë katerkendeshe me peshe 1 (nje) kg lageshtira jo me shume se 44.5%, poroziteti jo me pak se 72%, aciditei jo me shum se 45%. Furnizimi i bukes do të behet cdo ditë prane magazinave të Drejtorisë së Sherbimit Spitalor Tropoj sipas kërkesës. Amballazhi i transportimit të bukes duhet të jetë i pastër dhe të sigurojë mosdëmtimin e saj. Mjetet transportuese duhet të jenë të pastra, të mbyllura që të sigurohet transportim normal i bukes deri në destinacionin perkates.

MISH VICI – Të jetë i freskët, prodhim vendi, të jetë i kulluar, nga pamja e jashtme të jetë i mbuluar me një cipe të holle të thate. Siperfaqja e mishit pas prerjes të jetë e lagur dhe e ndritshme, lëngu del me vështësi dhe është i tejdukshëm. Si karakteristike të cilësive të mishit të vicit evidentojmë shijen e kendshme, lëngun e tejdukshëm dhe aromatic me pika yndyre në sipërfaqe. Mishi të jetë i cilësishëm së pari i shoqëruar me raporte analize nga Inspektorati Veterinar, me peshe deri në 80 kg, me përqindje të ulët dhjami dhe të ruhet në dhoma frigoriferike dhe në temperaturë 6-0 gradë C. transporti të behet me mjete frigoriferike të licensuara.

Pjesa e karkases (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.

Cdo parti/karkase mishi duhet të shoqërohet me certifikatë veterinarë, e cila garanton sigurinë e produktit „mish“ dhe me të cilën vërtetohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga semundje, por është i sigurtë dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

DJATHE I BARDHE - Kërkohet me baze prodhimi nënprodukte të qumështit të lopës, deles ose dhisë. Nuk lejohet prodhimi i djathit me perzierje të qumështit pluhur ose të konservuar. Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit, djathit të lopës, në ngjyrë të qumështit (krem), i deles dhe i dhisë të ketë ngjyrën karakteristike të qumështit të bardhë (kur djathi është i prodhuar me baze qumështi delje ose dhie). Lejohet djathë me përqindje yndyre jo me shume se 3%. Pamja e jashtme të jetë konforme, në brendësi proroze karakteristike të djathit të stazhionuar mirë. Sasia e kripës të jetë normale. Shija të jetë e mirë karakteristike të djathit normal pa erëra të tjera jot e kendshme. Amballazhi i jetë i shoqëruar deri 10-14 % kripe deti i mbyllur me kapak hermetik në mënyrë që të mos rrjedhë. Nuk lejohet me afat skadence me shum se një vit. Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë të cilësive të standarteve të miratuara. Në etiketë të jetë shënuar data e prodhimit, data e stazhionimit dhe data e skadencës.

QEPE – Kërkohet cilësia e parë, të jetë me pjekuri të plotë me cipe të bisht të thate, të shendosha e të plota me ngjyrë të formë tipike të kultivuara dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm. madhësia e kokrës për ovalet të jetë nga 48 cm dhe për llojet e tjera 5-10 cm. Lejohen jo me shume se 1% e parties me dëmtime të lehta dhe 1% lende të huaja. Me semundje nuk lejohen. Të ngrira të kalbura e të mykura nuk lejohen.

SPECI – Kërkohet cilësia e parë të jetë me formë të ngjyrë të kultivarit të freskët, të pastër dhe me pjekuri natyrale. Lejohen dëmtime jo me shume se 3%. Shija të jetë karakteristike e kultivarit. Lejohet shije e djegës e lehtë. Nuk lejohet perzierja e specit të djegës me atë jot e djegës. Gjatësia të jetë për të gjatët mbi 10 cm dhe për të rrumbullakët mbi 7 cm.

PERIME DHE ZARZAVATE TË TJERA – Të jenë të cilësive të parë, të pastra të freskët, pa

pembajtje dherash e kalbezimesh, të ambalazhuara në mënyrë që të mos emtohen gjatë transportit. Në këtë grup do të përfshihen sipas stinëve si patate, qepe etj, (sipas kërkesës së entit). Transporti I tyre të bëhet me mjete të pasta të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno*sanitare për transportimin e produkteve ushqimore. Perimet e vyshkura nuk pranohen . ato mbeten për llogari të operatorit sipërmarrës.

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktore me mjetet e furnitorit deri në magazinat e blerësit me automjete të pastra.

Përveç asortimenteve të mesiperm /autoriteti Kontraktore rezervon të drejtën e kërkesës për mallrat e tjera nga lista e mesipërme.

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktore me mjetet e furnitorit deri në magazinat e blerësit brenda orarit zyrtar të punës 08:00-16:00.

Përshkrimi I kërkesës të zbatimit të shërbimeve në lidhje me të:

Të gjitha artikujt e mesiperm do të furnizohen në baza të kërkesës së bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Tropojë. Ofertuesi duhet të sigurojë furnizime ritmike dhe pa problem për vetë natyrën e shërbimit të kësaj institucioni. Grafiku dhe lehtërimi i mallit do të përcaktohet në kontratën midis paleve.



KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1	2	3	4	5	6
Nr	Pershkrimi I mallrave	Njesia	Sasia	Çmimi/Njesi	vlera total
1	Buke gruri (1kg)	kg	3000		
2	Mish viçi cilesi 1	kg	350		
3	Salçice	kg	100		
4	Veze	cope	2500		
5	Vaj gjelle	litra	200		
6	Vaj ulliri	litra	10		
7	Oriz	kg	300		
8	Makarona	kg	250		
9	Makarona supe	kg	30		
10	Sheqer	kg	150		
11	Sode buke	kg	0,5		
12	Rigon	kg	1		
13	Vegete	kg	8		
14	Kripe	kg	30		
15	Biskota per bebe	kg	16		
16	Miell	kg	5		
17	Djath	kg	200		
18	Gjize	kg	10		
19	Gjalp	kg	200		
20	Salce	kg	100		
21	Majoneze	kg	1		
22	Qumesht kuti	litra	1730		
23	Salce kosi	kg	5		
24	Karrota	kg	50		
25	Kunguj mishi	kg	50		
26	Patellxhane	kg	30		
27	Presh	kg	150		
28	Laker	kg	150		
29	Specat	kg	80		
30	Domate	kg	100		
31	Kastraveca	kg	30		

Dokumentat Standarde të Tenderit

32	spinaq	kg	40		
33	Patate	kg	350		
34	Qepe	kg	350		
35	Pete Byreku	kg	30		
36	Grosh	kg	40		
37	Bishtaja	kg	120		
38	Hudher	kg	1		
39	Çaj mali	kg	4		
40	Molle	kg	20		
41	Portokalle	kg	20		
42	Mandarina	kg	20		
43	Amita te vogla	cope	250		
44	Uthull molle	litra	5		
45	Reçel fiku	kg	170		

Afatet e lëvrimit: Levrimi i mallrave do të behet nga data e lidhjes së kontratës me afat 12 mujor dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktore në magazine të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë me mjete të operatorit ekonomik fitues.



Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
----------	-------

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate

dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në

kontratë.

- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.

- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
